



Informatat mbi Projektin

Emri i Projektit:	Gratë: Qytetare aktive
Vlera e projektit:	€ 19, 379.85; Bashkëfinancimi N/A
Kohëzgjatja:	Fillimi: 03/10/2016 Përfundimi: 30/09/2017
Organizata implementuese:	N/A
Kontaktet e Organizatës (adresa, e-mail, telefonat):	Rr. Arberia III, pa numer. Prishtine, Kosovo 10000, www.womenforwomen.org Iliriana Gashi (Drejtoreshw vendore); email: igashi@womenforwomen.org , +37744398846 Vesa Reznijq-Pallaska (personi kontaktues për projekt); vpallaska@womenforwomen.org , +37744221657
Përfituesit e drejtëpërdrejtë:	Grupet e synuara: Gratë e marginalizuara të komunave Viti, Podujevë dhe Mitrovicë Përfituesit final: 90 gra të marginalizuara të të gjitha komuniteteve dhe grupi joformal i grave asambleiste të komunave Viti, Podujevë dhe Mitrovicë.
Partnerët:	N/A
Territori i synuar/shtrirja gjeografike:	Komunat Viti, Podujevë dhe Mitrovicë
Qëllimi i përgjithshëm:	Qëllimi i projektit është të fuqizohen gratë e marginalizuara nga tri komuna në Kosovë duke i ndërtuar njohuritë dhe kapacitetin për leadership të tyre për të marrë pjesë në proceset vendimmarëse në nivel fshati, komune dhe qendror dhe të angazhohen burrat si aleatë në këtë proces.
Aktivitetet kryesore:	<ol style="list-style-type: none"> 1.1. Identifikimi i 90 grave (30 për komunë) të cilat do të marrin pjesë në aktivitetet e projektit dhe do të përfaqësojnë interes e komunitetit që e përfaqësojnë. 1.2. Implementimi i trajnimit dy-ditor me 30 gra në secilën komunë mbi të drejtat e grave, angazhimin/pjesëmarrjen qytetare si dhe legjislacionin relevant dhe proceset për tu kandiduar për pozita udhëheqëse në nivel të fshatit dhe komunës. 2.1. Identifikimi i ekspertëve të cilët do ta lehtësojnë punëtorinë për përgatitjen e Planeve avokuese me grupet e grave në secilën komunë. 2.2. Implementimi i punëtorivë dy-ditore me 30 gra në secilën komunë për përgatitjen e planeve avokuese që i adresojnë a. të drejtat e grave; b. kujdesin shëndetësor; c. mbrojtjen e ambientit dhe d. zhvillimin ekonomik/punësimin. 2.3. Finalizimi i planeve avokuese për secilin grup të grave në të tri komunat. 3.1. Udhëheqësia e WfWI takohet me grupin jo-formal të grave asambleiste në secilën komunë për ta prezentuar projektin dhe për të kërkuar bashkëpunim. 3.2. Organizimi i takimeve të ndërsjellta në mes të 30 grave dhe grupit jo-formal të grave asambleiste në secilën prej tri komunave. 3.3. Organizimi i pjesëmarrjes së grave në takimet e rregullta të kuvendeve komunale dhe dëgjimeve publike, dhe organizimi i salloneve në secilën komunë ku gratë do t'i prezantojnë planet e tyre të avokimit në mesin e përfaqësuesve të ndryshëm të kuvendeve përkatëse komunale (përfshirë grupin jo-formal të grave asambleiste). 4.1. WfWI do t'i zhvilloj takimet me grupin e grave parlamentare për ta prezentuar projektin 4.2. Organizimi i takimeve shkëmbyese të 90 grave që do ta vizitojnë parlamentin dhe do të takohen me gratë parlamentare dhe së paku të 4 grave parlamentare të partive të ndryshme që do d'i vizitojnë disa fshatra. 5.1. Identifikimi i 45-50 burrave (rreth 15 për komunë) të cilët do të përfitojnë nga trajnimet tona për mbështetjen e fuqizimit social dhe ekonomik të grave. 5.2. Implementimi i trajnimeve dy-ditore me 15-17 burra në secilën komunë mbi rolin e grave në proceset vendim-marrëse dhe rolin e burrave si mbështetës të këtij procesi.
Rezultatet e pritura:	<p>Rezultati 1. Është arritur përmirësimi i komunikimit në mes të 90 grave të marginalizuara të tri komunave dhe grupit jo-formal të grave asambleiste të komunav gjegjëse.</p> <p>Rezultati 2. Është arritur përmirësimi i komunikimit në mes të 90 grave të marginalizuara të tri komunave dhe grupit të grave parlamentare.</p>

